



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:115296
Datë: 26.01.2022
Numri i dokumentit: 02646928

Ac.nr.10258/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi-kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Bujar Muzaqi anëtarë, në çështjen juridike të paditëses-propozueses K.TH, nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson F.G, Avokat nga Prishtina, rruga “.....” ”.....” Prishtinë, kundër të paditurit-kundërshtarit të sigurimit M.K me adresë banimi në rrugën “.....” Lagjia”.....”, p.n Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokati V.V nga Prishtina rruga “....” “.....”, “.....”, kati i parë banesa e parë, lidhur me çështjen juridike propozimi i caktimit të masës së sigurimit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditurit-kundërshtarit, të paraqitur, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4079/20, i datës 27.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.01.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të autorizuarit të paditurit/kundërshtarit të sigurimit M.K me adresë banimi në rrugën “.....” Lagjia “....”, p.n Prishtinë, ndërsa PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4079/20, i datës 27.09.2021, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.4079/20, të datës 27.09.2021, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar propozimin e paditëses/propozueses K.TH, nga Prishtina, t’i caktohet masa e sigurimit dhe t’i ndalohe kundërshtarit të sigurimit Milaim Krasniqi nga Prishtina të tjetërsojë, fshehë, ngarkojë, osë të disponojë me paluajtshmërinë e cila identifikohet si objekt ndërtimor, shtëpi 3 katëshe e cila gjendet në parcelën e identifikuar sipas numrit kadastral nr.P-“.....” me sipërfaqe prej 829.74 m2, në lagjen “.....” p.n Zona Kadastrale, Prishtinë e cila evidentohet me emrin e M.K dhe atë deri në vendosjen me vendim të formës së prerë sa i përket çështjes kryesore. Në pikën dy të dispozitivit Gjykata e ka refuzuar si

te pabazuar propozimin e propozueses K.TH, nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të caktohet para shënimi i të drejtës së pengut mbi sendin e paluajtshëm, paluajtshmërinë me numër kadastral “.....” me sipërfaqe prej 829.74 m2, në lagjen “.....” p.n Zona Kadastrale, Prishtinë e cila evidentohet me emrin e M.K dhe atë deri në vlerën 186,691.50 Euro. Në pikën tre të dispozitivit ka detyruar Zyrën Kadastale në Komunën e Prishtinës dhe Shërbimin Noterial në Prishtinë, që ndalimin nga paragrafi I të këtij dispozitivi ta evidentojnë në regjistrat përkatës të tyre.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurit/kundërshtarit të sigurimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, t’u aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën, ta ndryshojë aktvendimin e atakuar duke e refuzuar propozimin e paditëses për caktimin e Masës së Sigurisë, apo aktvendimin e atakuar me ankesë ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rivendosje apo rigjykim.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të paditurit-kundërshtarit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja-propozuesja përmes përfaqësuesit me datë 25.08.2020 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka parashtruar propozim për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet propozimi i saj, të caktohet masa e sigurisë me të cilën ka kërkuar që të aprovohet propozimi i saj, të caktohet masa e sigurisë me të cilën kundërshtarit të sigurimit M.K nga Prishtina t’i ndalohet të tjetërsojë, fshehë, ngarkojë, ose të disponojë me paluajtshmërinë e cila identifikohet si objekt ndërtimor, shtëpi 3 katëshe e cila gjendet në parcelën e identifikuar sipas numrit kadastral “.....” me sipërfaqe prej 829.74 m2, në lagjen “.....” p.n Zona Kadastrale, Prishtinë e cila evidentohet me emrin e M.K dhe atë deri në shumën prej 186,691.50 Euro deri në vendosjen me vendim të formës së prerë të çështjes kryesore.

Paditësja-propozuesja ndër të tjera ka deklaruar se me datë 30.07.2012 pranë Gjykatës Themelore ka paraqitur padinë për vërtetimin e bashkëpronësisë, në bazë të kontributit gjatë jetesës martesore kundër të paditurit M.K kundërshtarit të sigurimit. Gjykata lidhur me padinë me datë 22.02.2016 ka nxjerrë aktgjykimin C.2099/2012 me të cilën është aprovuar kërkesëpadija e paditëses K.TH. Në bazë të kërkesëpadiës i padituri-kundërshtari i sigurimit është detyruar që në emër të kontributit martesor prej vitit 2000 deri në 2012, paditëses K.TH t’i paguaj shumën prej 186,691.50 Euro, në emër të ½ të pjesës ideale për ndërtimin e shtëpisë biznes në Prishtinë, duke ja kompensuar shumën e lartëcekur me kamatë vjetore prej 8% duke filluar që nga data 01.03.2016 e deri në pagesën definitive, duke e theksuar se edhe pse tani aktgjykimi është prishur, konsiderojmë se i njëjti e ka konfirmuar të drejtën tonë subjektive të propozueses se sigurimit.

Ndërsa sa i përket kushtit të dytë për caktim të masës së sigurisë, të paraparë nga neni 297 paragrafi.1 pika b) të LPK-së i cili ka të bëjë me faktin se a ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurimit, pala kundërshtare do të pamundësonte realizimin e kërkesës, e që do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozueses së sigurimit. Propozuesja e sigurimit thekson se:

Paditësja është përballur me sulme të vazhdueshme verbale e fizike të manifestuara nga kundërshtari i sigurimit, i cili poashtu ka insistuar vazhdimisht që propozuesja e sigurimit së bashku më fëmijët e përbashkët ta lirojnë shtëpinë. Gjithashtu propozuesja e sigurimit ka theksuar së është në dijeni që kundërshtari i sigurimit është në marrëveshje për shitjen e shtëpisë me fqinjin të ashtuquajtur F.I i cili është potencuar se e ka marrë vetëm me qera objektin poshtë shtëpisë (depon) e nuk e ka blerë. Propozuesja ka vërejtur punëtor dukë nxjerrë gjësendet nga shtëpia si dhe duke u pastruar shtëpia në tërësi. Propozuesja në mbështetje të pretendimit të ekzistimit të rrezikut ka deklaruar se ka dorëzuar fotografi, kontratën mbi qiranë, nga të cilat vërehet qartë se kundërshtari i sigurimit e ka vënë në shitje shtëpinë, me të vetmin qëllim që propozuesja të mos mund ta realizoj kërkesën e saj. Tutje ka theksuar se i propozonë Gjykatës së shkallës të parë që ta aprovoj masën e sigurimit në të holla duke i'a ndaluar kundërshtarit të sigurimit M.K nga Prishtina, që të fshehë, ngarkojë, tjetërsojë paluajtshmërinë shtëpinë 3 katëshe, e cila gjendet në parcelën e identifikuar me numër kadastral “.....”.

I padituri- kundërshtari i sigurisë, në përgjigje ndaj propozimit për caktim të masës së sigurisë ka deklaruar se e kundërshtojnë në tërësi propozimin për caktim të masës së sigurisë, me të cilën do t'i ndalohet kundërshtarit të sigurimit M.K nga Prishtina që të tjetërsojë, fshehë, ngarkojë paluajtshmërinë shtëpinë 3 katëshe e cila gjendet në parcelën kadastrale nr “.....”, me sipërfaqe prej 829.74 m² në lagjen “.....” p.n zona industriale Prishtinë. I padituri-kundërshtari i sigurisë e ka kundërshtuar pretendimin e palës paditëse e cila pretendon se kanë qenë në bashkësi jashtëmartesore, duke theksuar se një gjë të tillë nuk e ka vërtetuar asnjë herë me asnjë provë të vetme. Ngase bashkësia jashtëmartesore mund të krijohet përmes kontratës mbi themelimin e bashkësisë jashtëmartesore apo përmes aktgjykimit të Gjykatës dhe si e tillë duhet të jetë e regjistruar në regjistrat përkatës të gjendjes civile. Poashtu është i rëndësishëm edhe fakti tjetër se i padituri M.K është person i martuar dhe kjo vërtetohet me certifikatë mbi lidhjen e martesës.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurisë, është i bazuar nga fakti se ekziston rreziku që pa caktimin e masës së sigurisë do të vështirësohet dukshëm realimi i kërkesës nga palët, i paraprë në nenin 297.1 pika b). Përkatësisht ka konstatuar se pa ekzistimin e rrezikut real se pa caktimin e masës së propozuar, pala paditëse do të mund të pësojë ndonjë dëm të riparueshëm. Gjykata, vlerësoi si të besueshëm pretendimin e propozueses se ajo ka kontribuar në krijimin e paluajtshmërisë- shtëpisë së lartcekur, krejt kjo e bazuar në shkresat e lëndës, nga të cilat shihet se propozuesja dhe kundërshtari i sigurisë kanë një fëmijë të përbashkët, poashtu shihet se paditësja ka punuar për një periudhë të gjatë në ndërmarrjen e të paditurit. Pretendimet për mosekzistim të bashkësisë jashtëmartesore dhe çështja e kontributit në pasurinë kontestuese, mënyrën dhe masën e tij, ka vlerësuar se janë çështje që do të vlerësohet gjatë shqyrtimit kryesor. Lidhur me propozimin e padiëses/propozueses, më të cilën ka kërkuar që të caktohet para shënimi i të dretjës së pengut mbi sendin e palujtshëm me numër kadastral “.....” me sipërfaqe prej 829.74m², në lagjen “.....”, p.n Zona Kadastrale Prishtinë e cila është e evidentuar në emrin e M.K dhe atë dëri në vlerën prej 186.691.50 Euro, të njëjtin e ka vlerësuar si të pa bazuar. Duke u bazuar në dispozitat e nenit 387.1 pika (I), lidhur me nenin 142.5 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Me përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk pajtohet Gjykata e Apelit pasi që aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n), dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është kontradiktor me arsyetimin e tij dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsyet e duhura për faktet vendimtare, aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të ekzaminohet për faktin se nga arsyetimi i fakteve vendimtare nga gjykata e shkallës së parë dhe në një pjesë të arsyetimi propozimi për caktimin e masës së sigurisë është vlerësuar si i bazuar e në pjesën tjetër është cekur se caktimi i masës së sigurisë është i pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, në aktvendimin e atakuar në arsyetimin e tij, në faqën e tretë paragrafi i tretë ka theksuar se “Ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse-propozueses për caktimin e masës së sigurimit është i bazuar”, ndërsa në faqen e katërt paragrafi i tretë i aktvendimit të atakuar Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se “... Gjykata e refuzojë propozimin e paditëses-propozuesja, duke gjetur se në rastin konkret është i pa bazë”. Ndërsa Gjykata në dispozitiv të këtij aktvendimi e ka aprovuar pjesërisht propozimin dhe e ka caktuar masën e sigurimit, andaj në këtë rast për Gjykatën ankimore arsyetimi i aktvendimit të atakuar, është i paqartë dhe kontradiktor, pasi që në këtë rast nuk përputhet të dhënat lidhur me caktimin e masës së sigurisë, kështu që Gjykata e Apelit lerëson se në këtë rast aktvendimin e atakuar e bënë të pa ekzekutueshëm.

Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që t'i eliminoj shkeljet qenësore që u paraqitën në paragrafët e mësipërme. Për të vendosur drejtë dhe meritorisht lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, gjykata e shkallës së parë gjatë ri procedurës duhet t'i vlerësojë thëniet dhe propozimet tjera ankimore dhe varësisht nga gjendja e vërtetuar faktike e me zbatim të drejtë të dispozitave materiale do të vendos drejtë dhe meritorisht lidhur me propozimin e propozueses të masës së sigurimit.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të paditurit, mirëpo meqenëse të njëjtat nuk patën ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe, Gjykata e Apelit është rezervuar në dhënien e arsyeve që dalin jashtë vlerësimit për çështjes së trajtuar në këtë rast

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
Ac.nr.10258/21, me datë 05.01.2022

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Nehat Idrizi, d.v